



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



SHËNDETI I TË RINJVE GJATË PERIUDHËS SË IZOLIMIT SOCIAL DHE FIZIK TË SHKAKTUAR NGA COVID19.

RAPORT DHE REKOMANDIME



Tetor, Tiranë 2020

**SHËNDETI I TË RINJVE GJATË PERIUDHËS SË IZOLIMIT SOCIAL
DHE FIZIK TË SHKAKTUAR NGA COVID19.**

RAPORT DHE REKOMANDIME

ISBN 978-9928-4602-1-9

Tetor, Tiranë 2020



SHËNDETI I TË RINJVE GJATË PERIU DHËS SË IZOLIMIT SOCIAL DHE FIZIK TË SHKAKTUAR NGA COVID19.

Grupi i punës:

Msc. Rediona Skëndaj- Shëndet Publik, Rrjeti “Y-PEER”
Msc. Andi Rabiaj- Shëndet Publik, Rrjeti “Y-PEER”

Armela Pengili, Qendra “ACT for SOCIETY”

Eleni Nanaj, Qendra “ACT for SOCIETY”

Marjo Rabiaj, Y-PEER Albania

Dizajn:

Anisa Kaso

Ky dokument është prodhuar nga Qendra ACT for SOCIETY në bashkëpunim me Rrjetin Kombëtar të Edukatorëve Bashkëmoshatar, Y-PEER, Albania në kuadër të “Iniciativës së Burrave të Rinj II - Burrat dhe Djemtë si partnerë në promovimin e barazisë gjinore dhe parandalimin e ekstremizmit dhe dhunës tek të rinjtë në Ballkan”, i mbështetur nga CARE International në Ballkan, Agjencia Austriake për Zhvillim dhe Oak Foundation.

Opinionet, gjetjet dhe përfundimet ose rekomandimet e shprehura në këtë studim janë vetëm të autorëve dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë ato të donatorit.

.....

This publication is produced by Center ACT for SOCIETY in collaboration with Y-Peer Network Albania within the framework of the project “Young Men Initiative II – The Men and Boys as Partners in Promoting Gender Equality and prevention of Youth Extremism and Violence in the Balkans”, supported by CARE International Balkans, Austrian Development Cooperation and OAK Foundation.

The opinions, findings and conclusions or recommendations expressed in this study are those of the authors only and do not necessarily represent those of the donor.



Adresa: Rruga: Bulevardi Zhane D'Ark; Ndertesa 61;
Hyrja 5; Apartamenti 24; Tirane/ Shqiperi.

E-mail: actsociety@gmail.com; Web: www.actforsocietycenter.org; Tel: +355(4) 44507447

Abstrakt

Shfaqja e COVID-19 si një emergjencë e shëndetit publik nga Organizata Botërore e Shëndetit ka sjellë një numër masash paraprake si karantina, distanca sociale ose në disa raste bllokime totale në rajon ose vende të botës.

Ky studim ka për qëllim që të identifikojë disa nga barrierat/sfidat dhe nevojat për shërbime shëndetësore të lidhura veçanërisht me shëndetin seksual dhe riprodhues të të rinjve gjatë izolimit social dhe karantinës si pasojë e pandemisë shkaktuar nga COVID-19 si dhe të krijojë ndërhyrje bazuar në të dhëna. Studimi përshkruan dhe analizon edhe probleme të tjera të lidhura nga izolimi social dhe karantina siç është shëndeti mendor, marrëdhëniet prindër-adoleshent, abuzimin me substancat me rrezik të lartë varësie siç është alkooli. Studimi nuk po shfaq analizë të thellë por vetëm ka për qëllim të përshkruajë situatën në të cilën janë gjendur të rinjtë si dhe ta krahasojë me studime të realizuar gjatë kësaj periudhe por dhe në situata të tjera të fatkeqësisë natyrore.

Abstract

The emergence of COVID-19 as a public health emergency by the World Health Organization has led to a number of precautionary measures such as quarantines, social distancing or in some cases total lockdown in region or countries around the world.

This study aims to identify some of the barriers / challenges and needs for health services related especially to the sexual and reproductive health of young people during social isolation and quarantine as a result of the pandemic caused by COVID-19 and to create interventions based on data. The study also describes and analyzes other problems associated with social isolation and quarantine such as mental health, parent-adolescent relationships, abuse of high-risk substances such as alcohol. The study does not introduce in depth analysis but only aims to describe the situation in which young people are but also to confront the studies conducted during this period but also in other situations of natural disaster.

Hyrje

Në situatën e COVID-19, me mbylljen e shkollave, shërbimeve të përditshme shëndetësore dhe Qendrave Komunitare, mënyra të reja për të dhënë informacion dhe mbështetje për adoleshentët dhe të rinjtë mbi të Drejtat e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues duhet të startojnë menjëherë.

Pandemia e shkaktuar nga COVID 19 ka rezultuar me pasoja ekonomike dhe sociale në të gjithë botën. Të rinjtë janë veçanërisht vulnerabël nga pasojat që pandemia ka sjellë, dhe shumë prej tyre janë në risk për të ngelur mbrapa në aspektin ekonomik, arsimor dhe shëndetësorë si dhe në mirëqenie gjatë një faze të rëndësishme të zhvillimit të jetës së tyre. Të rinjtë kanë më shumë gjasa që të jenë të papunë apo të kenë të pasigurt kontratën e punës dhe kështu, nuk kanë mbrojtje të përshtatshme sociale. Në të njëjtën kohë të rinjtë janë duke iu përgjigjur krizës nëpërmjet promovimit të kujdesit shëndetësorë, vullnetarizmit dhe inovacionit. Pas pandemisë, të rinjtë do të formojnë një element kyç në një rimëkëmbje gjithëpërfshirëse dhe arrijnë e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) gjatë kësaj dekade veprimi. Megjithatë përgjigja dhe rimëkëmbja duhet bërë në një mënyrë që të mbrohen të drejtat e njeriut dhe veçanërisht të drejtat e të rinjve. Të rinjtë në veçanti, janë përballur me vështirësi gjatë izolimit, pasi për herë të parë u detyruan të ndaheshin fizikisht nga bashkëmoshatarët e tyre si dhe nga partneri/ja intim/e. Një studim i kryer ndërmjet të rinjve në Evropën dhe Azinë Qendrore tregoi se shumë prej të rinjve filluan të kërkonin për informacion rreth problemeve mendore, dhunën seksuale dhe cyberbullying. Fëmijët dhe adoleshentët ka të ngjarë të kenë më shumë gjasa të kenë nivele të larta depresioni dhe ndoshta ankthi gjatë dhe mbarimit të karantinës (izolimi i detyruar). Këto nivele mund të rriten ndërsa izolimi i detyruar nga organet kompetente do të vazhdojë. Shërbimet klinike dhe parandaluese duhet të ofrojnë mbështetje dhe ndërhyrje në faza të hershme, kur është e mundur, dhe të jenë të përgatitura për një rritje të problemeve të shëndetit mendor gjatë pandemisë dhe pas pandemisë¹.

Të rinjtë kanë të njëjtat mundësi për tu infektuar me COVID-19 si personat e rritur dhe për të infektuar të tjerët në rast se nuk ndjekin në mënyrë rigorozë udhëzimet ndërkombëtare dhe kombëtare nga Institucionet dhe Specialistët e Shëndetit rreth parandalimit, testimit, kontrollit dhe kujdesit për të praktikuar distancimin social. Veçanërisht pas fazës së mbylljes dhe hapjes graduale të shoqërisë, të rinjtë janë një burim kryesor i shpërndarjes së virusit pasi rrjeti i tyre është më i madh dhe frekuentimi më i shpeshtë i vendeve publike, eventeve të ndryshme dhe praktikimi i sjelljeve të caktuara mund të shërbejë si katalizator për përhapjen e tij. Mbyllja e shkollave, shërbimeve shëndetësore dhe Qendrave Komunitare çoi në mënyra të reja për të dhënë informacionin dhe mbështetje për adoleshentët dhe të rinjtë, veçanërisht në shërbimet e Shëndetit Seksual dhe Riprodhues të cilat janë cilësuar si shërbime jetë shpëtuese gjatë situatave të fatkeqësive natyrore dhe emergjencave civile. Pandemia preku seriozisht edukimin formal të të rinjve. Sipas një raport të hershëm të UNESCO-s 107 shtete kanë implementuar mbylljen e shkollave në nivel Kombëtar, gjë e cila ka prekur 861.7 milion fëmijë dhe të rinj. Të rinjtë janë prekur gjithashtu nga mbyllja e mundësive të edukimit jo-formal, e cila i privon ata nga angazhimi social me bashkëmoshatarët. Periudha të zgjatura të mbylljes dhe kufizimeve të

¹ Loades ME et al. Rapid systematic review: The impact of social isolation and loneliness on the mental health of children and adolescents in the context of COVID-19. *J Am Acad Child Adolesc Psychiatry* 2020

lëvizjes mund të çojnë në trazira emocionale dhe në rritje të nivelit të ankthit. Nëse prindërit apo kujdestarët janë të infektuar, karantinuar, ose ndërrojnë jetë, atëherë çështjet psiko-sociale dhe të sigurisë për adoleshentët duhen adresuar patjetër. Edukimi, mekanizmat e mbështetjes sociale dhe aksesit në shërbimet shëndetësore duhet të mirëmbahen me prindërit dhe/ose kujdestarët të cilët luajnë një rol të rëndësishëm. Dhuna në familje dhe dhuna seksuale u trajtua që në hershmërinë e izolimit social veçanërisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe agjencitë ndërkombëtare. Vajzat adoleshente dhe vajzat e reja janë më të ekspozuara për të pasur nivele të larta të dhunës në familje si dhe nga partneri intim, fenomen ky i cili nxitet nga karantinimi dhe izolimi i detyruar për një kohë të gjatë. Kjo u pa shumë qartë nga rastet e shfaqura në televizionet kombëtare mbi rastet e abuzimit seksual dhe dhunës veçanërisht në komunitetet me mundësi të pakta apo dhe të marginalizuara. Shërbimet e kujdesit shëndetësor siç është testimi për HIV dhe Infeksioneve Seksualisht të Trasmetueshme, metodat kontraceptive, shërbimet gjinekologjike, shërbime për shëndetin seksual dhe riprodhues si dhe ato për dhunën më bazë gjinore, u reduktuan ndjeshëm për shkak të situatës duke rritur vulnerabilitetin veçanërisht komuniteteve të marginalizuar. Sistemi shëndetësor pësojë një stres të vazhdueshëm për të adresuar dhe parandaluar përhapjen e COVID19 duke rezultuar më ndërprerjen e ofrimit të shërbimeve normale të shëndetit seksual dhe riprodhues dhe informacionit për të rinjtë. Nevoja për këshillim dhe për shërbimet e shëndetit mendor është e lartë për shumë njerëz, përfshirë dhe të rinjtë, të cilët shfaqin nivele të larta të stresit dhe ankthit lidhur me COVID-19. Masa të përshtatshme duhen ofruar për të mbrojtur grupet vulnerable si të rinjtë emigrant, refugjatët e rinj, të rinjtë në arrest, të rinjtë me paftësi, të rinjtë me HIV dhe të rinjtë që jetojnë në varfëri.

Të rinjtë përfaqësojnë një burim dhe një rrjet të vlefshëm përgjatë krizës dhe emergjencave të shëndetit publik. Me trajnimin e duhur mbi sëmundjen dhe transmetimin e saj, të rinjtë mund të punojnë bashkë me autoritetet shëndetësore për të thyer zinxhirin e infeksionit. Ata mund të luajnë një rol të rëndësishëm në përhapjen e saktë të informacionit për COVID-19 dhe mbështesin shpërndarjen e informacionit për të ulur rrezikun, përgatitjen dhe përpjekjet kombëtare

Dizenjimi i studimit.

Ky studim u zhvillua pa burime shtesë dhe Google form e cila u përzgjodh si një platformë kosto efektive e cila na mundësonte ekstraktimin e të dhënave. Pyetësi u shpërnda në rrjetet sociale dhe ndërmjet organizatave rinore të cilat përfaqësonin grupime të ndryshme. Pyetjet ishin të mbyllura me qëllim që të na mundësonin mbledhje informacioni të shpejt dhe lehtësisht të analizueshëm.


Pyetësi kishte në përbërje 26 pyetje të ndara në 3 sesione

GJETJET KRYESORE TË STUDIMIT


Seksioni 1: Të dhënat demografike

Në këtë studim morën pjesë **230** pjesëmarrës. Gati $\frac{3}{4}$ e pjesëmarrësëve ose **76,2%** e tyre ishin të gjinisë femërore dhe gati $\frac{1}{4}$ ose **23,8%** ishin djem. Burimi kryesor i ndarjes së pyetësorit dhe ftesës për tu plotësuar nga të rinjtë ishin rrjetet sociale siç është Facebook dhe Instagram të rrjetit Y-PEER. Ndjekësit në këto dy rrjete sociale ruajnë të njëjtin raport gjinor dhe ishte e pritshme që raporti gjinor të shkonte afërsisht sipas ndjekësve të këtyre rrjeteve sociale. Gjithashtu pyetësi u shpërnda edhe nga partnerët tanë të rrjetit të organizatave “Zëri i të rinjve”. Shpërndarja moshore e pjesëmarrësëve është mjaft dinamike. Moshë më me interes për këtë studim ishte moshë 15-29 vjeç që përfaqëson **86,6%** të pjesëmarrësëve nga të cilët **13,4%** i përkasin grup moshës 15-19 vjeç dhe **73,2%** i përkasin grup moshës 20-29 vjeç. Kjo pjesëmarrje që përbën më shumë 4/5 e pjesëmarrësëve në studim na lejon dhe mundëson që të lexojmë të dhënat dhe rezultatet e këtij studimi. Ajo që vlen për tu theksuar në këtë sesion është dhe pjesëmarrja e personave që janë 30 vjeç ose më shumë, të cilët formuan një kampion prej **13,4%**. Megjithatë, në analizën e mëposhtme do të trajtohen të gjithë në të njëjtin status “të rinj”


Grafiku1




Grafiku 2



Përsa i përket nivelit arsimor të pjesëmarrësëve shpërndarjen e pjesëmarrësëve e shohim sipas grafikut nr 3, Pjesëmarrës që frekuentojnë gjimnazin janë afërsisht **11%**. Pjesëmarrës që frekuentojnë universitetin dhe janë afërsisht **56%** dhe ata që kanë kryer studime pas universitare janë gati **33%**. Për efekte studimore do të ishte me shumë vlerë në rast se do të kishim pjesëmarrës , të rinjtë të cilët nuk frekuentojnë shkollën që në termin e organizatave njihen me “Out of School Children and Youth”. Ndaj, një ndër mangësitë kryesore të studimeve online është fakti që nuk arrijnë dot të arrijnë grupet vulnerable dhe grupet me mundësi të pakta.




Grafiku nr 3



Një ndër grupet më të prekura nga pandemia e shkaktuar nga COVID19, ishin të punësuarit dhe veçanërisht të rinjtë e punësuar. Nga ana tjetër masat e ndërmarra për të ulur zinxhirin e transmetimit të virusit dhe për të ulur ekspozimin, shkollat dhe universitetet u

pezulluan dhe mësimdhënia tradicionale u zëvendësua me mësimdhënien Online. Në këtë studim morën pjesë **36,8 %** student, **45,5%** ishin të punësuar ndërsa pjesa tjetër raportuan se ishin të papunësuar.




Përsa i përket statusit civil, duke pasur parasysh grup moshën që u ftua të merrej pjesë në studim prisnim që shumica e pjesëmarrësëve të ishin në mënyrë të konsiderueshme beqar ose në lidhje. Gati **46%** ishin beqar/e ndërsa **29%** ishin në një lidhje. Ndërsa gati **23%** u shprehën se ishin të martuar.

Nga të dhëna demografike mund të themi se kemi një grup pjesëmarrësish në studim divers, i cili mund të na ofrojë një informacion shumë të vlefshëm mbi situatën e përjetuar nga të rinjtë, fenomenet që po hasen dhe nevojat e tyre. Informacion tjetër i vlefshëm mund të dali nën dritën e fakteve dhe të dhënave të gjeneruara nga analiza studimore.


Sesioni II

Qëndrimi në fshat gjatë karantinës dhe qëndrimi në qytet gjatë karantinës ofron dy perspektiva hetimi shumë të mira. Karantina në qytete paraqet mjaft sfida për shkak të dendësisë së madhe të popullatës, përqendrimin e shërbimeve jetike. Tirana përbën gati **32%** të popullatës ndërsa qyteti i dytë pas Tiranës që është njëkohësisht

Durrësi dhe Fieri përbëjnë **20%** të gjithë popullatës². Popullsitë urbane janë mësuar me një shkallë të lartë lëvizshmërie. Karantina e kufizon lëvizshmërinë duke ndikuar në mënyrë të konsiderueshme në jetën e përditshme të të rinjve të cilët janë grupi i popullatës më një dinamikë dhe lëvizshmëri më të madhe. Të qëndruarit në fshat gjatë karantinës u mundëson të rinjve lëvizshmëri më tepër se të rinjtë që e kaluan periudhën e karantinës në qytet, kjo përkthehet në pasoja më të paktë përsa i përket veçanërisht shëndetit mendor të lidhura me izolimin. Në studimin tonë gati **79%** e pjesëmarrësëve në studim raportuan se kishin qëndruar në qytet gjatë kohës së karantinës dhe pjesa tjetër kishin qëndruar në fshat gjatë karantinës.



Grafiku nr 6



Grafiku nr 6

Që prej shfaqjes së virusit Sars Cov2, për herë të parë në media, shkaktoi shqetësim, frikë, pasiguri për shkak të përhapjes së tij të shpejt në shtete të ndryshme duke shkaktuar shumë humbje jete dhe shumë persona të infektuar. Mbyllja shumë shërbimeve, mbyllja e çerdheve, shkollave, universiteteve, vendosja e karantinës dhe izolimit social, ndalimi i lëvizjes së lirë dhe vendosja e fashave të orareve rriti frikën, stresin, ankthin, trishtimin dhe pikëllimin ndërmjet të rinjve dhe pjesës tjetër të popullsisë duke qenë larg shkollës, punës, bashkëmoshatarëve dhe

² INSTAT JANAR 2020


përshtatja me mënyrat e reja të mësimi dhe punës si dhe balancimi i punëve të shtëpisë dhe përgjegjësitë për përkujdesjen ndaj fëmijëve apo dhe më të moshuarve. Diskriminimi, frika dhe dezinformimi u shpërndanë po aq shpejt sa dhe pandemia. Të gjitha këto patën një efekt domethënës në mirëqenien emocionale. Rritja e informacionit dhe shqetësimeve janë duke afektuar në mënyrë të drejtpërdrejtë shëndetin mendor në të gjithë globin³.

Në fillimet e veta shumë raportime nga Organizata Botërore e Shëndetit por dhe nga shumë agjenci ndërkombëtare siç është Qendra e Kontrollit të Sëmundjeve në Amerikë apo Shërbimi Kombëtar Shëndetësor në Mbretërinë e Bashkuar raportojnë për një virus i cili kishte “*marrëdhënie të mira*” me mosha e rritura dhe me personat të cilët bashkëjetonin me sëmundje të tjera. Të rinjtë dhe fëmijët u cilësuan si rezistent ndaj pasojave të virusit por si burim potencial transmetimi i virusit drejt prindërve, të afërmeve të tyre apo anëtarëve të tjerë të shoqërisë ndaj masat për parandalimin e përhapjes e virusit u kërkuar që të respektoheshin nga të gjithë. Megjithatë së fundmi raportimet e përditshme në vendin tonë dhe jashtë saj raportojnë për një ulje të moshës së personave të infektuar dhe personave të shtruar në spital.


Të rinjtë që morën pjesë në studimin tonë përgjithësisht kishin frikë nga infektimi me virusin COVID19 nga ku **46%** raportuan se kishin pak frikë për tu infektuar nga virusi, **32 %** raportuan se kishin frikë në nivel të konsiderueshëm dhe gati **9%** raportuan se ishin shumë të frikësuar nga infektimi me COVID19. Megjithatë duke marrë parasysh kohën në të cilën u mbledhën të dhënat dhe kur akoma situata ishte e paqartë, nivelet e raportimit janë të ngjashme me shumë studime të realizuara në vende të tjera të botës.

Raportet përmbyseshin për pyetjen “nëse kishin frikë se familjarët e tyre mund të infektoheshin”. Të rinjtë kishin frikë për infektimin e familjarëve të tyre më shumë seç kishin frikë për infektimin e tyre. **35.5%** kishin shumë frikë për infektimin e familjarëve, **34,6%** u shprehën se kishin frikë në mënyrë të konsiderueshme për infektimin e të familjarëve dhe **28,6%** kishin pak frikë. Këto të dhëna janë tregues shumë i rëndësishëm për orientimin e mesazhe kundrejt kësaj kategorie.

³ Torales, J., O'Higgins, M., Castaldelli-Maia, J. M., & Ventriglio, A. (2020). The outbreak of COVID-19 coronavirus and its impact on global mental health. *The International journal of social psychiatry*.



Grafiku nr 7




Grafiku nr 8

Karantina është shpesh një përvojë e pakëndshme për ata që i nënshtrohen asaj. Ndarja nga të dashurit, humbja e lirisë, pasiguria për statusin e sëmundjes dhe mërzitja, me raste, mund të krijojnë efekte dramatike. Përfitimet e mundshme të karantinës së detyrueshme masive duhet të peshohet me kujdes kundër kostove të mundshme psikologjike. Përdorimi i suksesshëm i karantinës si masë e shëndetit publik kërkon që strategji të ndryshme të zvogëlojnë, sa është e mundur, efektet negative që lidhen me të. Studime të ndryshme kanë vëzhguar personat që kanë qenë në karantinë si pasojë e viruseve të tjera dhe një përgjithësi kanë raportuar një përhapje të lartë të simptomave të shqetësimeve dhe çrregullime psikologjike siç ishin simptoma të

përgjithshme psikologjike, shqetësime emocionale, depresion, stres, humor të ulët, nervozizëm, pagjumësi, simptoma të stresit post-traumatik, zemërim dhe rraskapitje emocionale.

Të dhënat tregojnë se të rinjtë, pjesëmarrës në këtë studim, nuk e kanë përjetuar mirë qëndrimin në shtëpi. Ata kanë shfaqur simptoma të ankthit dhe stresit. Nga studimi vetëm **8,3%** e të rinjve raportuan se nuk kishin asnjë ndryshim gjatë qëndrimit në karantinë. **40,7%** e pjesëmarrësëve raportuan se qëndrimin në karantinë i ka stresuar dhe **16,5%** i ka bërë ankthioz/e. Po ashtu, në përqindje të konsiderueshme kanë raportuar se janë marrë me gjera që më parë nuk kanë pasur kohën për ti bërë dhe gati **11%** raportuan se ishin qetësuar gjatë qëndrimit në shtëpi si pasojë e karantinës.



Grafiku nr 9


Ajo çka pritej dhe çka shumë të rinj shkruanin dhe raportnin mbi raportin e tyre me prindërit apo gjyshërit, ishte fakti se shpesh herë gjatë karantinës përballja ndërmjet gjeneratave ishte e theksuar. Për herë të parë adoleshentët dhe të rinjtë po kalonin shumicën e kohës me familjarët e tyre. Adoleshenca është një fazë tranzicioni, ku ndryshimet biologjike, emocionale dhe fizike të cilat ndikojnë dukshëm në raportin prindër – fëmijë⁴. Gjatë karantinës prindërit dhe të rinjtë duhet të riorganizojnë përgjegjësitë e tyre duke u orientuar drejt një marrëdhënie ku përfitimet dhe detyrat janë ndarë në mënyrë të barabartë me të gjithë anëtarët e familjes. Studime të tjera raportuan marrëdhënie ndërmjet izolimit / vetmisë dhe të menduarit rreth vetëvrasjes, vetë-dëmtimit dhe çrregullimit të ushqyerit⁵.

Rezultatet treguan se shumica e të rinjve ishin afër me shumë më të afërmit e tyre ndërsa një pjesë e vogël e tyre kishin tendencën të kishin mos përshtatje me ta. Afërsisht **14%** e të rinjve


4 Development of Parent–Adolescent Relationships: Conflict Interactions as a Mechanism of Change

5 Loades ME et al. Rapid systematic review: The impact of social isolation and loneliness on the mental health of children and adolescents in the context of COVID-19. J Am Acad Child Adolesc Psychiatry 2020

raportuan së nuk ndiheshin më të afruar me familjarët e tyre gjatë fazës së karantinës. Megjithatë, ajo që vlen për tu theksuar është fakti si gati gjysma e personave që kishin kaluar karantinën me prindërit e tyre **(51,5%)** u shprehën se ndiheshin më të afruar me familjarët. Një ndër problemet më të mëdha që të rinjtë e vuajtën gjatë karantinës ishte ndarja nga bashkëmoshatarët e tyre. **12.6%** u shprehën se kishin nevojë të flisnin me bashkëmoshatarët e tyre. Afërisht **17%** e të rinjve raportuan se shpesh herë përfundojnë në diskutime të ndryshme me prindërit e tyre.



Grafiku nr 10




Grafiku nr 11


Këtu nuk përjashtohen shërbimet shëndetësore dhe shërbimet sociale të cilat u minimizuan dhe prioritzuan shërbimet me të rëndësishme. Sipas urdhrit nr.159 datë 11/03/2020 “Për kufizimin e lëvizjes së pacientëve, shoqëruesëve dhe/ose familjarëve dhe organizimin e shërbimeve në institucionet e kujdesit shëndetësor ku kryhen vizitat dhe konsultat ambulatorë” shumica e shërbimeve shëndetësore u kanalizuan në shërbime online veçanërisht për personat më të rriskuar siç janë të moshuarit dhe personat me sëmundje kronike. Nga ana tjetër pezullimi transportit publik ndikoi drejt për drejt në aksesueshmërinë e shërbimeve shëndetësore, shërbimeve sociale apo shërbime të tjera. Mungesa e transportit publik apo dhe frika nga infektimi ndikojnë në marrjen e shërbimeve shëndetësore. Rezultatet treguan se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve kishin nevojë për shërbime shëndetësore. Nga studimi ynë **38%** e të rinjve kishin nevojë për shërbime shëndetësore nga të cilët **88%** nuk kanë shkuar për të marrë shërbime shëndetësore.

Arsyet kryesore të mos marrjes së shërbimeve shëndetësore janë : frika nga infektimi me gati **17%**, mungesa e transportit **8%**, kufizimet në orar **4%**, për shkak të largësisë **6%**; dhe **35,5%** e të rinjve që kishin nevojë për shërbime shëndetësore por nuk i kishin marrë raportuan se kishin arsye të tjera që nuk kishin marrë shërbim shëndetësor.

Me vendosjen e karantinës së detyruar, kufizimet në lëvizje sipas një fashë orari dhe me leje të posaçme dhe me vonë shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore me 24 Mars 2020 si pasojë e rritjes së rasteve të personave të prekur nga COVID19. Kjo nënkupton që shumica e aktiviteteve të përditshme u kufizuan në minimumin e domosdoshëm përfshirë dhe organet publike.



Grafiku nr 12



Grafiku nr 13

adoleshentët, stigma dhe diskriminimi mbi aktivitetin seksual ndërmjet të rinjve, akses i dobët në edukimin seksual gjithëpërfshirës, pengesa në marrjen e shërbimeve shëndetësorë për ndërprerjen e sigurt dhe ligjore të shtatzënive. Si rezultat, gjatë pandemisë të rinjtë janë në rrezik për të përjetuar më shumë shtatzëni të paqëllimshme, aborte jo të sigurt, infeksione seksualisht të transmetueshme (IST) dhe komplikime që vijnë nga shtatzënitë e hershme. Aksesit në metodat moderne kontraceptive është një përbërës integral në mbrojtjen e autonomisë dhe sigurisë së riprodhimit të lirë të një individi. Situata e krijuar ka sjellë uljen e kërkesës për kontraceptivë për shkak të pasojave negative të mos qenit në gjendje për të patur akses në këto shërbime.


Realiteti është se pandemia do të ketë një ndikim vërtet shkatërrues në të ardhmen e miliona grave dhe vajzave. Krizat kanë risk që të deprivojnë shërbimet e shëndetit riprodhues. Pavarësisht se këto shërbime janë cilësuar jetë shpëtuese dhe thelbësore për mbrojtjen e të

drejtave të njeriut, akoma vazhdojnë të mos cilësohen prioritare gjatë krizave humanitare, fatkeqësive natyrore apo emergjencave civile. Shërbimet e planifikimit familjar, metodat moderne kontrceptive, kujdesi shëndetësor për abort të sigurt, parandalimi i shtatzënive të paqëllimshme, artikujt e shëndetit menstrual, aksesit në marrjen e kondomëve, ndjekja e shtatzënisë dhe post shtatzënisë, shërbimet që lidhen me personat që jetojnë me HIV/AIDS, plotësimi i nevojave të paplotësuara me metoda të planifikimit familjarë, lufta ndaj martesave të hershme, lufta ndaj dhunës me bazë gjinorë, janë të gjitha shërbime të cilat nuk duhet të ndalen në asnjë moment. Të rinjtë dhe veçanërisht vajzat janë përballur me pengesa të konsiderueshme në qasjen në informacione dhe shërbimet thelbësore të shëndetit seksual dhe riprodhues para krizës COVID-19. Tani, në mes të një pandemie që po sforcon edhe sistemet më të fuqishme të kujdesit shëndetësor, ekziston një rrezik i vërtetë që të drejtat e shëndetit seksual dhe riprodhues të mos arrihen plotësisht. Sipas një vlerësimi të realizuar nga UNFPA (Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë) rreth 47 milion gra në 114 vende me të ardhura të ulëta dhe të mesme parashikohet të mos jenë në gjendje të përdorin kontraktivë modernë nëse bllokimi apo masat e lidhura me COVID-19, vazhdojnë për 6 muaj duke detyruar që një pjesë e shërbimeve shëndetësore, përfshirë dhe ato të shëndetit riprodhues të qëndrojnë të mbyllura.

Studimi tregoi që të rinjtë kanë pasur nevojë për shërbime të shëndetit seksual dhe riprodhues. **39%** e të rinjve pjesëmarrës në studim kanë raportuar se kanë pasur nevojë për shërbime të shëndetit seksual dhe riprodhues nga të cilët **20.8%** kanë pasur nevojë për shërbime por nuk kanë mundur dot ta marrin shërbimin. Ndërkohë që **5.2%** kanë mundur që të marrin shërbim duke u paraqitur fizikisht në qendrat shëndetësore dhe **13%** kanë marrë shërbime online.

Grafiku nr 14

Për cfarë keni pasur nevojë?



■ Arsye të tjera

■ Këshillim mbi shtatzëninë

■ Këshillim për planifikim familjar


■ Këshillime me mjekun

■ Mjete moderne kontrceptive

■ Vizita mjekësore


Nga grafiku i mësipërm dallojmë qartësisht që nevoja për mjete moderne kontraceptive ka qenë në krye të nevojave të rinjve gjatë periudhës së karantinës. Rreth **28%** e të rinjve që kanë pasur nevojë për shërbime të SHSR, kanë pasur nevojë për metoda moderne kontraceptive. **10.4%** kanë patur nevojë për këshillim dhe vizitë mjekësore. Ndërsa nevoja për tu këshilluar për shtatzëninë dhe këshillim për planifikimin familjarë ka qenë nga **0.9%** për secilën.

Mënyrat më të përdorura për dhënien e informacionit gjatë pandemisë COVID-19 janë interneti, rrjetet sociale si dhe media. COVID 19 ka qenë në fokus të çdo medie televizive, Institucioneve




Shtetërore, organizatave por dhe individëve të caktuar. Njësoj si me shërbimet shëndetësore të SHSR, informacioni rreth shëndetit seksual dhe riprodhues gjatë pandemisë nuk është kategorizuar si i nevojshëm nga

institucionet shëndetësore, mediat apo shumë organizata që punojnë me të rinjtë. Siç shikohet dhe nga grafiku nr. 14 gati **24%** e pjesëmarrësëve në studim kanë deklaruar se nuk janë ekspozuar ndaj informacionit për çështjet që lidhen me fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues gjatë pandemisë. **26.4%** dhe **21.6%**, janë ekspozuar mesatarisht dhe pak ndaj këtij informacioni ndërsa **23.8%** janë ekspozuar shumë. Duke mbajtur në konsideratë se shumica e pjesëmarrësëve në studimin online janë ndjekës të rrjeteve sociale të Y-PEER Albania (Facebook dhe Instagram) kanë marrë gjatë kësaj periudhe shumë informacione të vlefshme dhe të rëndësishme mbi këtë tematikë. Ky fakt (bias në studim) na bënë të besojmë se përqindja e të rinjve që kanë marrë informacione të duhura mbi SHSR është shumë herë më e vogël nga çka është raportuar në këtë studim.




Të rinjtë nuk dinë se ku mund të gjejnë metoda kontraceptive. Edhe përpara pandemisë, të rinjtë kanë pasur mungesë informacioni mbi metodat moderne kontraceptive si dhe ku mund ti përfitojnë ato. Pandemia ka rritur frikën për të

aksesuar shërbimet shëndetësore për shkak të ekspozimit ndaj virusit. Ndaj dhe kërkesa për metoda kontraceptive ka shënuar një rënie domethënëse. Nga ana tjetër, këto shërbime nuk janë adresuar dhe nuk ka një plan të mirëfilltë që adreson aksesin në shërbimet e shëndetit riprodhues përfshirë dhe metodat kontraceptive. Gati **32%** e pjesëmarrësëve raportuan se nuk dinin se ku mund të gjenin këto metoda gjatë pandemisë. Gati **48%** dinin se ku mund të merrnin shërbime apo metoda kontraceptive.



Stigma, tabu-të, sistemi patriarkalë dhe kultura konservatore, ka krijuar një mjedis jo mbështetës për të rinjtë dhe shëndetit të tyre seksual dhe riprodhues në Shqipëri. Pasojat e këtij mjedisi jo mbështetës janë më të mëdha ndërmjet vajzave të reja dhe adoleshente. Pyetjes nëse kishin ndrojtje kur pyesni për çështjet e shëndetit seksual dhe riprodhues, 16.5% raportuan se kishin ndrojtje të pyesnin mbi këto çështje. Gati **24%** u shprehën se kishin disi ndrojtje.




COVID 19 ka rritur rrezikun që gratë dhe vajzat të përjetojnë një rritje të dhunës me bazë gjinore. Sipas UNFPA-së, pandemia e shkaktuar nga COVID19 ka të ngjarë që të minojë përpjekjet për t'i dhënë fund dhunës me bazë gjinorë përmes dy rrugëve:

- Ulja e përpjekjeve për parandalim dhe mbrojtje. izolimi gjithashtu nënkupton që shërbimet mjekësore dhe mbështetja për njerëzit e prekur nga dhuna seksuale me bazë gjinore mund të ndërpriten ose konsiderohen më pak të rëndësishme në strukturat e kujdesit shëndetësor të cilat janë të mbingarkuara duke iu përgjigjur rasteve të COVID-19 në vend.
- Rritja e incidencës së dhunës në familje dhe nga partneri intim për shkak të izolimit për shumë kohë në shtëpi.

Sipas një vlerësimi të bërë nga UN Women në Shqipëri, në muajin Mars të këtij viti, që përkon dhe me muajin e karantinës pas shpalljes së pandemisë, janë raportuar 141 raste të dhunës më shumë se në muajin mars të vitit të kaluar. Fëmijët dhe të rinjtë janë të riskuar për tu abuzuar gjatë izolimit dhe karantinës. Mbyllja e shkollave nënkupton që mijëra fëmijë dhe të rinj janë në rrezik të qëndrojnë në izolim me familjet e tyre abuzive. COVID19 ka detyruar ndërprerjen e burimeve mbështetëse dhe shumë prej tyre janë “jashtë radarit” dhe ende të panjohur për shërbimet që ofrojnë mbështetje dhe ndihmë. Të rinjtë si para dhe gjatë pandemisë mbetën përdoruesit kryesorë të rrjeteve sociale (facebook, instagram dhe së fundmi tik-tok). Pandemia shënoi një rritje e përdorimit në mënyrë dramatike të rrjeteve sociale apo platformave të tjera online, veçanërisht nga të rinjtë. Të rinjtë janë ekspozuar akoma më shumë ndaj “cyber violence”, formave online të dhunës me bazë gjinorë veçanërisht ndaj vajzave e shoqëruar me pasojë psikologjike, sociale dhe me pasojë në shëndetin riprodhues.




Dhuna fizike dhe/ose psikologjike ka qenë prezent ndërmjet të rinjve në periudhën e karantinës. Vetëm 3 pjesëmarrës (vajza) raportuan se ishin prekur nga dhuna fizike dhe/apo psikologjike në nivel të konsiderueshëm dhe shumë gjatë kohës së karantinës dhe 21 pjesëmarrës u shprehën se ishin prekur pak nga këto forma të dhunës (19 vajza dhe 2 djem), Ndërsa 36 vajza raportuan se nuk e dinin nëse kishin rënë pre e dhunës me bazë gjinore kundrejt 3 djemve.




Raportimi i formave të dhunës mbetet akoma një problem. Dhuna vazhdon akoma të mos raportohet. Nga pjesëmarrësit në studim që raportuan se ishin prekur nga dhuna gjatë kohës së karantinës, vetëm (1.6%) prej tyre e kishte raportuar ndërsa 4.8% raportuan se nuk dinin

se ku mund ta raportonin. 93.7% nuk e kishin raportuar. Këto janë të dhëna mjaft të rëndësishme për tu patur në konsideratë për forcimin e fushatave ndaj dhunës me bazë gjinore dhe njohja e mënyrave të raportimit të dhunës.

Përsa i përket ngacmimeve në rrjetet sociale gati **27%** e pjesëmarrësëve në studim raportuan se kishin rënë pre e kësaj forme të dhunës dhe vetëm **4.6%** (**3 persona**) e tyre e kishin raportuar ndërsa **63.1%** u shprehën se nuk dinin se ku ta raportonin. **32.3 %** raportuan se nuk e kishin raportuar. Vajzat raportuan gati 2 herë më shumë ngacmime se djemtë në rrjetet sociale (**17.3% kundrejt 9.5%**).





Gjumi është një proces biologjik kritik, dhe e vërteta është se gjithmonë është i rëndësishëm. Sidoqoftë, kur përballeni me pandeminë COVID-19 gjumi bëhet akoma më i rëndësishëm. Gjumi është kritik për shëndetin fizik, mendor dhe atë psiko-social por dhe në dimensione të tjera të shëndetit si dhe në funksionimin efektiv të sistemit imunitar. Të plotësosh nevojat për gjumë si dhe të flesh shëndetshëm, do të thotë të kesh më shumë aftësi për të luftuar dhe mposhtur stresin, depresionin dhe ankthin, simptoma këto të shfaqura dhe raportuara nga të rinjtë gjatë periudhës së karantinës. Pyetjes “A ka ndryshuar cilësia dhe sasia e gjumit gjatë karantinës” gati **43%** raportuam se cilësia e gjumit u kishte ndryshuar shumë ndërsa **25.5%** e pjesëmarrësëve u shprehen se i ka ndryshuar konsiderueshëm dhe gati **27%** u shprehën se u ka ndryshuar pak cilësia e gjumit. Në krahun tjetër do të shohim se **0.4%** janë shprehur se cilësia dhe sasia e gjumit është bërë më e mirë dhe **4.3%** u shprehën se cilësia e gjumit nuk ka ndryshuar aspak.



Stresi dhe frika e rritur gjatë periudhës së COVID19, veçanërisht faza e parë e cila u shoqërua me masa drastike siç ishte karantina, izolimi dhe distancimi fizik, mund të udhëheqin në rritjen e niveleve të përdorimit të alkoolit. Fatmirësisht vetëm një pjesë e


vogël e të rinjve kishin konsumuar alkool në raport me pjesën tjetër që nuk kishin konsumuar alkool. Pjesëmarrësit në studim u pyetën nëse kishin konsumuar alkool gjatë periudhës së karantinës. **1.3%** kishin konsumuar shumë alkool, **30.3%** kishin konsumuar pak alkool ndërsa **3.5%** kishin konsumuar në nivel të konsiderueshëm. Ndërsa **64.9%** nuk kishin konsumuar alkool gjatë kësaj periudhe. Megjithatë, studimi nuk përcaktoi çfarë do të cilësohej pak, konsiderueshëm apo shumë alkool. Kjo u la në gjykimin e pjesëmarrësëve për ta vendosur sipas gjykimit të tyre.



Studimi tregoi që izolomi social ka ndikuar disi ndërmjet çifteve duke sjell diskutime dhe grindje. Përsa i përket ndikimit të distancimit fizik në raportin me partnerin intim **71%** e pjesëmarrësëve ose **164** të rinj u përgjigjën kësaj pyetjeje. Gati **24%** raportuan se kishin pasur grindje dhe diskutim me partnerin e tyre. Ndërkohë që

afërsisht **10%** u shprehen se ishin larguar akoma më shumë krahasuar me **20.7%** që raportuan se ishin afruar më shumë. Ndërsa **45.7%** raportuan se distancimi fizik nuk kishte ndikuar në marrëdhënien e tyre me partnerin. Të rinjtë u pyetën rreth marrëdhënieve me partnerin e tyre gjatë periudhës së karantinës. Të dhënat ishin mjaft interesante duke pasur parasysh që të rinjtë janë grupmosha e cila është më seksualisht aktive. Frika ndaj infektimit me COVID19 ka ndikuar në kryerjen e marrëdhënieve ndërmjet çifteve (grafiku nr 22). Gati **44%** raportuan se kishin kryer marrëdhënie gjatë kësaj periudhe kundrejt **36.6%** të cilët raportuan se nuk kishin kryer marrëdhënie si pasojë e frikës së infektimit por dhe pa ndonjë arsye konkrete. Përdorimi i masave mbrojtëse ndaj shtatzënive të paqëllimshme por dhe ndaj infeksioneve seksualisht të


transmetueshëm duhet promovuar vazhdimisht dhe në çdo rrethanë. Mungesa e aksesit në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues mund të çojë në



rritje të shtatzënive të paqëllimshme, shtatzënive të hershme si dhe infeksioneve seksualisht të transmetueshme. **Përdorimi i masave mbrojtëse gjatë karantinës, ndërmjet të rinjve, ka qenë ne nivel të ulët pavarësisht se të rinjtë janë grupi me seksualisht aktiv.**

50.7% e të rinjve që kishin kryer marrëdhënie, vetëm **13%** e tyre raportuan se kishin përdorur masa mbrojtëse. Kjo është një e dhënë shqetësuese për nivelin e përdorimit të masave mbrojtëse ndërmjet të rinjve dhe veçanërisht gjatë periudhës së karantinës.

Ashtu siç është trajtuar më sipër nivelet e dhunës fizike apo psikologjike gjatë periudhave të fatkeqësive natyrore apo emergjencave kanë një tendencë rritje. Për të parë se si ka qenë prezentë ndërmjet pjesëmarrësëve në studim, pyetëm të rinjtë se sa herë janë grindur me partnerin e tyre gjatë periudhës së karantinës. **12%** raportuan se ishin grindur më shumë se tre herë me partnerin e tyre në dy javët e fundit ndërsa **28.6%** raportuan si ishin grindur **1-3** herë në dy javët e fundit.



Konkluzione

Që prej fillimit të saj pandemia e shkaktuar nga COVID19 u shoqërua me frikë, pasiguri dhe shumë të panjohura. Pavarësisht se të rinjtë trajtohen si grupi më pak vulnerabël përse i përket sëmundshmërisë dhe pasojave që vijnë prej saj, COVID19 tregoi se nuk përzgjedh përse i përket infektimit. Studimi tregoi që të rinjtë përgjithësisht kanë më shumë frikë për infektimin e familjarëve të tyre se sa infektimit të vetë vetes së tyre. Kjo është një pikë shumë e mirë për tu konsideruar në adresimin e mesazheve ndaj të rinjve. Ashtu siç është konfirmuar edhe gjatë shpërthimeve të tjera epidemike, izolimi, distancomi fizik, karantina sjellin një rritje të nivelit të ankthit, stresit apo simptoma të tjera siç mund të jetë depresioni apo çrregullime emocionale. Studimi tregoi se të rinjtë e përfshirë në këtë studim kanë një rritje të nivelit të stresit gjatë qëndrimit në karantinë si dhe rritje të nivelit të ankthit. Në krahun tjetër, karantina ka sjellë edhe pasoja pozitive siç është qëndrimi në shtëpi më familjarët. Gati gjysma e të rinjve raportuan se izolimi i ka bërë të ndihen më të afruar me familjarët. Megjithatë kjo nuk rezultoi e njëjtë për të gjithë të rinjtë pasi një pjesë e tyre përfundonin në diskutime të vazhdueshme me familjarët e tyre dhe kishin nevojë të flisnin me dikë dhe veçanërisht me bashkëmoshatarët e tyre. Me shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë shëndetësore dhe izolimit fizik, aksesit në shërbimet dhe veçanërisht në shërbimet shëndetësore u bë shumë e vështirë për shkak të masave në fuqi (dalja në orare të caktuara dhe me leje, mungesa e transportit por dhe frika e infektimit në mjediset shëndetësore). Më shumë se 1/3 e të rinjve raportuan se kishin nevojë për shërbime shëndetësore gjatë periudhës së karantinës shumica dërrmuese e tyre nuk kishin shkuar për të marrë shërbime krahasuar me një pakicë të cilët kishin marrë shërbime shëndetësore. Frika nga infektimi dhe mungesa e transportit ishin dy nga faktorët kryesorë që pengoi marrjen e shërbimeve shëndetësore. Shërbimet shëndetësore të dedikuara shëndetit seksual dhe riprodhues janë ndër shërbimet më esenciale dhe jete shpëtuese për grup moshat seksualisht aktive ku shumica janë të rinjtë. Pavarësisht se këto shërbime janë jete shpëtuese gjatë fatkeqësive natyrore, nuk u cilësuan prioritare si para, gjatë dhe pas fatkeqësive natyre përfshirë dhe epidemitë/pandemitë. Studimi u fokusua në nevojat e të rinjve për këto shërbime dhe më shumë se 1/3 e tyre kishin pasur nevojë për këto shërbime dhe shumica prej tyre nuk arriti të përfitonte këto shërbime pavarësisht se u vu në dispozicion një numër jeshil për të gjitha shërbimet shëndetësore në vend. Kërkesat kryesore ishin për mjete moderne kontraceptive. Megjithatë duhet theksuar se edhe para pandemisë niveli i përdorimit të mjeteve moderne kontraceptive është raportuar shumë i ulët pavarësisht se të rinjtë i njohin shume mire, të paktën një metodë kontraceptive. Po ashtu edhe niveli i informacionit se ku mund të përfitojnë këto shërbime para pandemisë ka qenë shumë i ulët. Kjo mbështetet dhe më faktin se 1/3 e pjesëmarrësëve në këtë studim raportuan se nuk dinin se ku të gjenin metoda kontraceptive apo shërbime të shëndetit riprodhues. Institucionet përgjegjëse si dhe organizatat që punojnë në fushën e shëndetit seksual dhe riprodhues duhet të bëjnë përpjekje më të mëdha për rritur ndërgjegjësimin ndërmjet të rinjve por dhe brenda sistemit shëndetësor për të prioritetizuar shërbimet e shëndetit riprodhues gjatë gjendjes së fatkeqësisë shëndetësore. 1 në 5 të rinj raportuan se nuk ishin ekspozuar aspak ndaj informacionit për shëndetin seksual dhe riprodhues gjatë pandemisë. Duke pasur parasysh që shumica e të rinjve që plotësuan pyetësonin online janë anëtarë të rrjetit Y-PEER dhe rrjetit të Organizatave “Zëri i të Rinjve”, të cilat janë organizata që punojnë në këtë fushë, niveli i aksesimit të këtij informacioni është akoma më i ulët ndërmjet të rinjve. Që prej fillimit të pandemisë, agjencitë ndërkombëtare por dhe

institucionet kombëtare, bënë thirrje për shtim të dhunës mundësuar nga situata e krijuar, veçanërisht izolimi për kohë të gjatë. 2/3 e të rinjve raportuan se nuk kishin rënë pre e dhunës qoftë fizike apo psikologjike. 1/5 e të rinjve raportuan se nuk e dinin nëse kishin rënë pre e dhunës fizike apo psikologjike. Qoftë edhe një rast i vetëm dhunë ndërmjet të rinjve është shqetësuese për gjithë shoqërinë. Trende rritëse të dhunës më bazë gjinore janë raportuar gjatë periudhës së pandemisë. Të njëjtat trendë mund të dallojmë dhe në studimin tonë ku vajzat e reja janë më të prekura nga ky fenomen. Shqetësuese është edhe raportimi i këtij fenomeni pasi vetëm një prej pjesëmarrësëve në studim kishte raportuar dhunën. Rritja e ndërgjegjësimit kundra dhunës më bazë gjinore apo çdo forme tjetër dhune si dhe raportimi duhet të jetë top prioritet për çdo organizatë dhe për çdo institucion shtetëror. Rrjetet sociale mbeten vendi i preferuar i ngacmimeve ku me te ekspozuara mbeten vajzat por serish ashtu si në rastin e dhunës fizike dhe/apo psikologjike raportimi mbetet akoma në nivele shumë të ulëta. Akoma më shqetësuese është fakti se shumica e të rinjve nuk dinë se ku mund të behet raportimi i ngacmimeve që ndodhin në rrjetet sociale. Studimi nxjerr në pah që në mënyrë shumë të dukshme të rinjtë kanë shfaqur probleme me cilësinë dhe sasinë e gjumit e cila është një nga simptomat kryesore që lidhet me friken, ankthin dhe stresin që ka shoqëruar shpërthimin e pandemisë. Fatmirësisht këto simptoma nuk janë shoqëruar në shtim të përdorimit të alkoolit ndërmjet të rinjve ku vetëm një pakicë shumë e vogël raportuar përdorim të tepër të alkoolit. Të rinjtë janë grupi më seksualisht aktiv dhe me nevoja për tu kujdesur për shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues siç është aksesit në mjetet moderne kontraceptive me qëllim parandalimin e shtatzënive të hershme dhe të paqëllimshme si dhe mbrojtën nga infeksionet seksualisht të transmetueshme. COVID19 u shoqëruar me pikëpyetje nëse kryerja e marrëdhënieve ndërmjet partnerëve intim mund të shërbente si mjet për të transmetuar virusin COVID19. Thyerja e distancimit gjatë ose jo marrëdhënieve seksuale mund të sjellë risk të shtuar për të marrë infeksionin. Kjo u reflektua edhe ndërmjet të rinjve ku një pjesë shumë e vogël e të rinjve pjesëmarrës në studim raportuan se nuk kanë kryer marrëdhënie pasi kishin frik nga infektimi me COVID. Ashtu si dhe studimi demografik shëndetësorë 2018-2019 në Shqipëri i cili tregoi një rënie të përdorimit të mjeteve moderne kontraceptive në vendin tonë, edhe ky mini studim tregoi që përdorimi i mjeteve kontraceptive ndërmjet të rinjve që kishin kryer marrëdhënie gjatë periudhës së izolimit dhe karantinës ka qenë në nivele shumë të ulëta. Megjithatë duhet pasur parasysh se gjatë kësaj periudhe akseset dhe mundësitë për të marrë metoda kontraceptive kanë qenë shumë të pakta. Kjo periudhë është shoqëruar gjithashtu me diskutime ndërmjet partnerëve intim.

Rekomandime:

Të rinjtë duhet të përfshihen në ndërhyrjet e dizenuara nga Institucionet Shtetërore po aq sa dhe te jenë në fokus të ofrimit të shërbimeve gjatë situatave të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore. Bota në dallim me dhjetëra vite me parë kur është përballur me pandemi të këtij niveli, ka alternative, mjetet komunikimi, shërbime dhe ajo që duhet theksuar ka teknologjinë dhe eksperiencën që më parë nuk e ka pasur. Pavarësisht eksperiencës që ka tashmë, përsëri të rinjtë nuk përfshihen në planet e ndërhyrjes, rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike si dhe ofrimin e shërbimeve gjatë dhe pas pandemisë. Të rinjtë, të cilësuar si grupmosha më pak vulnerable kundrejt sëmundjeve dhe pasojave të saj, janë një armë e shtuar, me plot vlerë dhe ide inovatore në kështoj situatash. Disa nga rekomandime kryesore janë si më poshtë:

1. Përfshirja e të rinjve në planet e përgjigjes dhe rimëkëmbjes gjatë dhe pas situatave të fatkeqësive natyrore. Gjithashtu të rinjtë duhet të jenë pjesë e planeve të rimëkëmbjes ekonomike dhe atë sociale.
2. Organizatat e shoqërisë civile, agjensitë ndërkombëtare dhe si shërbimi kombëtar i rinisë në Shqipëri duhet të integrojnë në planet e veta të punës trajnimin e të rinjve për të ofruar shërbime “Peer to Peer” gjatë situatave humanitare. Manualët që janë të përgatitura nga UNFPA por dhe nga agjensi të tjera që punojnë në fushën e të rinjve, janë burime të mira për tu konsideruar. Rrjeti Y-PEER, si një ndër rrjetet e pakta që ka në përbërjen e vetë trajner me eksperiencë në këtë fushë mund të jenë një aset i shtuar në këtë drejtim.
3. Shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, të cilat janë cilësuar si jetë shpëtuese, duhet të jenë aktive dhe të mirë drejtuara gjatë situatave të ngjashme. Nevojat për këto shërbime janë të larta jo vetëm ndërmjet të rinjve por dhe ndërmjet anëtarëve të tjerë të shoqërisë. Sistemi shëndetësorë duhet të ofrojë sa më shpejt këto shërbime veçanërisht ndaj të rinjve që u përkasin grupeve të marxhinalizuara.
4. Aksesin ndaj mjeteve moderne kontrceptive duhet të jetë në çdo moment dhe në çdo vend. Të rinjtë dhe adoleshentët duhet të jenë të informuara se ku mund të aksesojnë dhe të kenë informacionin e duhur për përdorimin e tyre.
5. Organizimi i shërbimeve derë më derë nëpërmjet klinikave të lëvizshme duhen promovuar dhe nxitur veçanërisht për grupet me mundësi të pakta.
6. Shfrytëzimi i kanaleve të komunikimit online për ofrimin e shërbimeve psikologjike me qëllim parandalimin e pasojave në shëndetin mendor gjatë dhe pas pandemisë. Koordinim i përbashkët ndërmjet organizatave dhe institucioneve shtetërore si dhe shkollave/universiteteve. Çdo shkollë dhe universitet tashmë ka profilin e vetë në rrjetet sociale si dhe web-sitin. Këto hapësira online, duhet të kthehen në burim informacioni, ndërgjegjësimi, përcimi i mesazheve tashmë të verifikuara. Duke ndjekur shembullin e institucioneve shëndetësore dhe atyre vartëse, e njëjti parim mund të përdoret me institucionet edukuese të cilët kanë një numër shumë të madhe ndjekësish që janë të rinjtë që frekuentojnë këto mjedise ose që i kanë frekuentuar me herët. Mesazhet dhe informacioni mund të adresohet në formë dhe mënyra të ndryshme përfshirë takimet virtuale, video, postera informues, quizz, etj. si dhe të jenë të fokusuara në shëndetin mendor dhe atë riprodhues të rinjve pa harruar efektet negative dhe pasojat që lindin si pasojë e pandemisë.
7. Fuqizimi i të rinjve për të identifikuar në kohë dhunën me bazë gjinore, dhunën seksuale si dhe dhunën kibernetike si dhe raportimi në organet përgjegjëse.

Pikat e dobëta të studimit.

Studimi ka një sërë dobësish por që nuk ia zbehin aspak rezultatet e marra pasi në analizë janë konsideruar dhe mbajtur parasysh pikat e tij të dobëta. Së pari studimi ka një numër jo shumë të madhe pjesëmarrësish e cila nuk na ka lejuar të shkojmë më thellë në analizë. Së dyti biasi i përzgjedhjes së pjesëmarrësëve në studim. Studimi ka qenë i orientuar për të përfshirë pjesëmarrësit online dhe si i tillë është plotësuar më së shumti nga të rinjtë të cilët kanë një tendencë për të qenë me të ndjeshëm ndaj temave të tilla si dhe janë ndjekës të rregull të faqes se facebook të rrjetit Y-PEER dhe të Rrjetit të organizatave “Zëri i të rinjve”. Ky grup është më i ekspozuar ndaj informacioneve të shpërndara në mënyrë periodike mbi situatën e krijuar si pasojë e COVID19 por dhe temave që janë të shprehura në studim. Kjo bënë që rezultatet të mos jenë ato që kanë dalë në përfundim të analizës së të dhënave.

Bibliografia:

1. <https://www.unfpa.org/resources/impact-covid-19-pandemic-family-planning-and-ending-gender-based-violence-female-genital>
2. <https://www.unfpa.org/resources/covid-19-reporting-gender-based-violence-during-public-health-crises>
3. <https://www.unfpa.org/covid19>
4. <https://www.unfpa.org/resources/covid-19-working-and-young-people>
5. <https://www.ippf.org/covid19>
6. <https://www.ippf.org/blogs/how-will-coronavirus-affect-access-safe-abortion>
7. <https://www.ippf.org/blogs/covid-19-and-rise-gender-based-violence>
8. <https://www.cdc.gov/coronavirus/2019-nCoV/index.html>
9. <https://www.nhs.uk/conditions/coronavirus-covid-19/>
10. <https://www2.unwomen.org/en/digital-library/multimedia/2020/4/infographic-covid19-violence-against-women-and-girls>
11. <https://www.actforsocietycenter.org/ndikimi-i-izolimit-social>
12. <https://womendeliver.org/press-media/>
13. <https://www.who.int/reproductivehealth/publications/emergencies/COVID-19-SRH/en/>
14. https://www.who.int/publications/i/item/WHO-2019-nCoV-Comm_health_care-2020.1
15. <https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/gender-based-violence-and-covid-19.html>
16. <https://www.coe.int/en/web/youth/covid-19>



With funding from
 Austrian
Development
Cooperation



SHËNDETI I TË RINJVE GJATË PERIUDHËS SË IZOLIMIT SOCIAL DHE FIZIK TË SHKAKTUAR NGA COVID19.

RAPORT DHE REKOMANDIME



Tetor, Tiranë 2020